



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

**VENDIM**

**Nr. 420, datë, 29.09.2022**

**PËR LICENCAT DHE TARIFAT E SHËRBIMIT TË OPERATORËVE UK DERI NË  
PËRFUNDIM TË PROCEDURAVE TË RIORGANIZIMIT DHE TRANSFERIMIT  
TË SHOQËRIVE UK NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA**

Në zbatim të neneve 14, gërma “e” dhe “i” dhe 19 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, për “Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.302, datë 11.05.2022 ”Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, në të cilin edhe ERRU ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni Kombëtar Rregullator, duke patur në konsideratë periudhën kohore që ju nevojitet njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe shoqërive UK për përfundimin e procedurave të riorganizimit në subjekte me kompetenca të përbashkëta (SKP-UK):

**VENDOSI:**

1. Shoqërive ujësjellës-kanalizime të cilat janë të pajisura me licencë nga ERRU për operatorët që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, dhe kanë firmosur marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta (SKP) sipas vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.302, datë 11.05.2022 ”Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, ERRU u jep të drejtën e transferimit të licencave ekzistuese në Subjektin e Kompetencave të Përbashkëta.
2. Shoqëritë UK që përfundojnë procedurat e riorganizimit në formën e Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.302, datë 11.05.2022 ”Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, duhet të aplikojnë pranë ERRU brenda tre muajve nga përfundimi i procesit të plotë të transferimit, për pajisjen me licencë të re shërbimi në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për licencimin e tyre.
3. Shoqëritë SKP-UK do të përdorin tarifën aktuale për zonat e shërbimit të miratuara nga ERRU, deri në miratimin e tyre, nga Komisioni Kombëtar Rregullator. SKP mbas marrjes së licencës nga ERRU, paraqet aplikimin për rishikimin dhe miratimin e tarifave, që do të kryhet bazuar në të dhënat e një viti ushtrimor të aktivitetit të shoqërisë SKP. Procedurat për miratimin

e tyre do të kryhen në përputhje me nenin 22 te ligjit 8102 date 28.03.1996 " Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator Nr.539, datë 30.12.2021 "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime".

4. Shoqëritë SKP-UK të krijuara sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", Kreu II, pika 3, kanë detyrimin për të shlyer pagesat rregullatore vjetore sipas kontratave respektive të secilës shoqëri UK deri në aplikimin dhe miratimin e tarifave të reja.

5. Bazuar ne ligjin 8102, datë 28.03.1996, për "Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, neni 10, pika 1, gërma a, pas miratimit të tarifave të reja, ERRU do të lidhë kontratë me SKP-UK për detyrimet e pagesës rregullatore ndaj ERRU-së.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë UK dhe SKP-UK si dhe të gjitha strukturat e ERRU.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Ndriçim Shani**